



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
INSPEKTORATI SHTETËROR SHËNDETËSOR

Nr. 763/1, prot, Datë 12. 04. 2016



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I MJEKËVE TË SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR

Nr. 40, prot, Datë 12. 04. 2016

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

MIDIS

INSPEKTORATIT SHTETËROR SHËNDETËSOR DHE PRESIDENTIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË URDHRI TË MJEKËVETË SHQIPËRISË

Kryeinspektori I Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor dhe Presidenti I Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë (në vijim të quajtura “Palët”)

Duke vlerësuar rëndësinë e ushtrimit të profesionit të mjekut në mënyrë sa më korrekte dhe në shërbim të plotë të pacientëve dhe të publikut,

Duke konsideruar si një ndër objektivat prioritarë në ushtrimin e veprimtarisë së tyre, zbatimin e kuadrit ligjor me qëllim përmirësimin e standarteve të larta profesionale tek mjekët në të gjithë vendin, dhe zbatimin e angazhimeve reciproke për arritjen e këtij qëllimi,

Duke afirmuar vullnetin e mire dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në funksion të realizimit të qëllimit të këtij memorandumi;

Duke u mbështetur në kuadrin e plotë ligjor që normon veprimtarinë e tyre institucionale dhe administrative: Ligjin Nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr. 10 107, datë 30.03.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 147/2014 "Për shërbimin e urgjencës mjekësore", ligjin nr. 7761, datë 19.10.1993 "Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse", i ndryshuar, ligjit nr. 9952, datë 14.07.2008 "Për parandalimin dhe kontrollimin e HIV/AIDS –it", i ndryshuar; ligjin nr. 10 138 "Për shëndetin publik", i ndryshuar, ligjin nr. 8045, datë 07.12.1995 "Për ndërprerjen e shtatëzanisë", ligjit nr. 8876, datë 04.04.2002 "Për shëndetin riprodhues", ligjit nr. 10 454, datë 21.07.2011 "Për transplantimin e indeve, qelizave dhe organeve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr.7643, datë 02.12.1992 "Për inspektimin Sanitar", i ndryshuar si dhe aktet nënligjore që rregullojnë fushën e shërbimit mjekësor, ligjit Nr. 123/2014 "Për Urdhrin e Mjekëve të Shqipërisë",

Kanë rënë dakord të lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi (në vijim“Memorandumi”).

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i memorandumit është bashkëpunimi midis dy institucioneve për garantimin e respektimit të kuadrit ligjor dhe nënligjor që rregullon ofrimin e shërbimit mjekësor sipas legjislationit në fuqi, nëpërmjet ushtrimit të inspektimeve të përbashkëta si dhe shkëmbimit të informacionit.

Neni 2

Forma e bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi sipas këtij Memorandumi realizohet nëpërmjet:
 - a. Ngritjes së grupeve të përbashkëta të inspektimeve
 - b. Shkëmbimit të informacioneve reciproke në funksion të efikasitetit të inspektimit të kërkesave ligjore që rregullojnë shërbimin mjekësor në institucionet publike dhe jopublike
 - c. Ndërmarrjen e veprimeve të përbashkëta për ndreqjen e mangësive të konstatuara gjatë ushtrimit të inspektimeve të përbashkëta

Neni 3

Angazhimet e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor

1. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor përmes strukturave të tij merr përsipër kryerjen e detyrave të mëposhtme:
 - a. Të mos lejojë ushtrimin e profesionit të Mjekut në institucionet e kujdesit shëndetësor pa u pajisur me Lejen (licensën) e Ushtrimit të Profesionit nga Urdhri i Mjekut,
 - b. Të informojë Urdhërin e Mjekut mbi masat administrative që janë marrë në inspektimet e ushtruara në institucionet e kujdesit shëndetësor.

Neni 4

Angazhimet e Urdhërit të Mjekut

1. Urdhri i Mjekut të Shqipërisë merr përsipër kryerjen e detyrave të mëposhtme:

- a. T'i sigurojë Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor informimin e domosdoshëm mbi mangësitë e konstatuara gjatë veprimtarisë monitoruese e kontrolluese si dhe bashkëpunimin e nevojshëm për ndreqjen e tyre,
- b. Të sigurojë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të tij në grupet e përbashkëta të inspektimeve me Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor.

Neni 5

Ndryshimi i Memorandumit

Ky memorandum mund të ndryshojë vetëm me marrëveshje të palëve nëpërmjet shkëmbimit Të komunikimit me shkrim.

Neni 6

Afati i Memorandumit

Ky memorandum lidhet për një afat të pacaktuar. Palët mund të bien dakord në çdo kohë për përfundimin e këtij memorandum.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandum zgjidhet me Mirëkuptim mes palëve.

Neni 8

Hyrja në Fuqi

Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe publikohet në faqet Zyrtare të internetit të palëve.

Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 5 (pesë) kopje origjinale, 2 (dy) prej të cilave Depozitohen pranë Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, 2 (dy) të tjerat pranë Urdhërit të Mjekëve dhe 1 (një) në Ministrinë e Shëndetësisë.

KRYEINSPEKTORI I ISHSH

Z. ELTAR DEDA

**PRESIDENTI I KËSHILLIT
KOMBËTAR TË UMSH**

Z. FATMIR BRAHIMAJ